



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Predato Received / Delivered	27 - 10 3	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMShCK	6725 / 2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1166/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1166/2023, të datës 15.09.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted], nga Gjilani, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike ‘kontestim konkursi’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1.1, nen paragrafin 1.1; nenin 16 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e në mbështetje të Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1166/2023, e datës 15.09.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] (tani e tutje referuar si ankuesja), me datë 15.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 6126/2023, e regjistruar nën shenjen A.nr.1166/2023, kundër rezultateve të vlerësimit lidhur me Konkursin me numër të kodit RPC0005228, për emrin e grupit “Specialist i Arsimit”, pozitën e punës “Inspektor i Arsimit”, Regjioni Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Arsimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 12.10.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6126/2023 të datës 15.09.2023, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitur nga fq.nr 3/134 Përgjigjeje në ankesë me numër protokollit 1166/2023, e datës 12.10.2023, aplikacioni i ankueses i datës 27.05.2023, së bashku me dokumentacionin e aplikimit nga fq.1/92, Vendimi N.05/151 i datës 12.07.2023 i Qeverisa së Kosovës, Vendimin Nr.140/1/2023 të datës 11.09.2023 për Vlershmin përfundimtar të kandidateve, Renditjen Përfundimtare të kandidateve të datës 11.09.2023; Lista e kandidateve të aprovuar-lista e ngushtë (pa datë dhe nënshkrim), Njoftimin lidhur me listën e ngushtë i datës 10.07.2023 të DMZP-së; Njoftimin për plotësimin dhe ndryshimin e listës së ngushtë i datës 19.07.2023 të DMZP-së; Konkursin me numër të referencës RN00011611; lidhur me emrin e grupit Specialistë të Arsimit, Ankesa e ankuese se datës 15.09.2023 e parashtruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur fq.2/65.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____, është e parakohshme, sepse:

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur së Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 05.05.2023 (afati për aplikim 26.05.2023 –05.06.2023) ka shpallur Konkursin për pranim, me numër të referencës RN00011611, për emrin e grupit “Specialist i Arsimit”, për pozitën “Inspektor i Arsimit, Gjilan” Institucioni: Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Inspektorati i Arsimit të Kosovës, klasa “Profesional 1” tri (3) vende.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, duke u përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit, mirëpo që i njëjta sipas Renditjes Përfundimtare të Vlerësimit të datës 11.09.2023, është vlerësuar me gjithsej 74.2 pikë duke u renditur si kandidati i 11-të.

Ankuesja e pakënaqur me Vlerësimin përfundimtar, me datë 15.09.2023, parashtron ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe po në të njëjtën datë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar rezultateve të vlerësimit lidhur me Konkursin për emrin e grupit “Specialist i Arsimit”, pozitën e punës “ *Inspektor i Arsimit*”, Regjioni Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Arsimit.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 25 paragrafët 4, 5, dhe 6, ku përcaktohet se: “...4.Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshëm ky nen i kësaj Rregulloreje.” si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, fillimisht, duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Komisioni i Pranimit, e me tej, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar afatet ligjor sipas nenit 127 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës rezultojnë së ankuesja me datë 15.09.2023, ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke kundërshtuar vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit, dhe po në të njëjtin ditë, pra ende pa përfunduar afati ligjor për vendosje të ankesës nga Komisioni i Pranimit, parashtron ankesë (me objekt të njëjtë) në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, nisur nga ky fakt, rrjedhë së ankesa e ankueses A.nr.1166/2023, e parashtruar me datë 15.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A. nr.1166/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Arkivit të KPMSHCK-së